



**Shoqata e Përkthyesve dhe Interpretuesve e Republikës së Maqedonisë së Veriut
(SHPRM)**

shpall

DEKLARATË

Me rastin e paraqitjeve të shumta të politikanëve, historianëve dhe akademikëve të shquar bullgarë për paraqitjen e gjuhës maqedonase si dialekt apo normë letrare të gjuhës bullgare

Në lidhje me mohimin e gjuhës maqedonase si gjuhë e veçantë e cila i përket grupit të gjuhëve sllavo-jugore, Shoqata e Përkthyesve dhe Interpretuesve e shpreh qëndrimin e vet mbi këtë çështje, të argumentuar në vijim:


SHPRM-ja rikujton se çdo gjuhë, duke përfshirë edhe maqedonishten, është pjesë e identitetit kulturor dhe nacional të një populli, dhe ajo nuk mund të preket, nuk lejohet të ndryshohet dhe përshtatet sipas kërkesave të individëve apo grupeve që të fitojnë pikë politike apo të demonstrojnë fuqi dhe forcë.

SHPRM-ja rikujton Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, e cila në nenin 19 përcakton lirinë e mendimit dhe shprehjes së çdo njeriu. Rezoluta e OKB-së u bën thirrje të gjitha vendeve anëtare të OKB-së, midis të cilave edhe Bullgarisë, t'i ruajnë dhe t'i mbrojnë të gjitha gjuhët që i flasin popujt në botë.

Si rrjedhim, SHPRM-ja kundërshton ashpër çdo lloj mohimi të gjuhës maqedonase nga personat zyrtarë të Republikës së Bullgarisë të cilët këto ditë dalin me qëndrime që janë në kundërshtim me konventat dhe dokumentet ndërkombëtare të cilat i mbrojnë dhe kujdesen për gjuhët.

Gjithashtu, SHPRM-ja i hedh poshtë të gjitha qëndrimet e shprehura, të paargumentuara dhe pa baza shkencore, të cilat nuk kanë asgjë të përbashkët me linguistikën, sllavistikën dhe historinë. Nga publiku bullgar shkencor, i udhëhequr nga përkthyesit bullgarë dhe profesorët e gjuhëve, kërkojmë të pajtohen me realitetin objektiv shkencor të klasifikimit të gjuhëve sllave.

Gjuha maqedonase ka një traditë të gjatë letrare e cila i pararend datës së normimit të saj: duke filluar me “Fjalorin tri gjuhësh” të Puleskit në shekullin e 19-



të, pastaj me “Abetaren” (Abecedar) e botuar nga pushteti grek në vitin 1925 si dhe me librat shkollorë të gjuhës maqedonase të botuar në Bullgari në fundin e viteve të '40-ta të shekullit të kaluar, kur fillon mësimdhënia në gjuhën maqedonase amtare dhe sipas regjistrimit të atëhershëm, 63,7% e popullatës në Maqedoninë e Pireut janë shprehur si maqedonas.

Për ne, përkthyesit dhe interpretuesit, gjuha maqedonase nuk është vetëm mjet me të cilin punojmë, por është edhe qenësia jonë, tradita jonë, identiteti ynë, i rrënjësuar thellë në veprat e vëllezërve Milladinovci, Iloskit, Racinit, të Andreevskit, Janevskit, Koneskit, gjuhë në të cilën flasim, komunikojmë, pohojmë, gjuhë në të cilën përkthejmë dhe prej të cilës përkthejmë, në të cilën shkruajmë dhe rrëfejme.

Gjuha maqedonase është gjuhë e gjallë e cila mësohet dhe flitet në të gjitha nivelet e arsimit, e cila përdoret në fushën shkencore dhe kërkimore, edhe në vendin tonë edhe në të gjitha vendet ku jeton pakicë maqedonase, si dhe në katedrat e shumta në botë ku studiohet maqedonistika. Gjuha maqedonase është gjuhë në të cilën janë përkthyer me mijëra vepra letrare, janë përshtatur mijëra faqe poezi, kurse prej para pak kohësh, edhe gjuha e cila shfaqet si gjuhë pune e veçantë edhe në shumë institucione ndërkombëtare.

Si rrjedhim, **SHPRM-ja u bën thirrje** institucioneve shtetërore, shoqatave të tjera profesionale, të gjithë individëve dhe ata që kanë të njëjtin mendim me ne, miqve e vendit tonë dhe respektuesve të gjuhës maqedonase, të shprehen kundër këtyre presioneve joparimore, që nuk janë tipare i botës demokratike të shekullit të XXI, të cilit i nevojitet gjuha e respektimit të ndërsjellë, në vend të gjuhës së urrejtjes, shantazheve dhe mohimeve.

Shkup më, 19 nëntor 2020